

VENDIM
Nr.372, datë 28.8.1992

PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT
PËR SHTETASIT SHQIPTARË QË VDESIN BRENDA DHE JASHTË SHTETIT

Me propozim të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Buxheti i shtetit të financojë shpenzimet për:

- a) arkivolin
- b) hapje, mbylljen e varrit
- c) elementet e betonit
- d) transportin e kufomës
- e) varrin provizor.

SHpenzimet e tjera për lajmërimet e vdekjes, kurorat, transportin me autobus etj. të përballohen nga familja.

2. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të organizojë shërbimin e sjelljes së kufomave të shtetasve shqiptarë që dërgohen me shërbim ose kurim jashtë shtetit dhe për shtetasit shqiptarë që kanë qenë me banim në Shqipëri dhe janë larguar mbas datës 1.1.1990. Për këtë dy automjete që ka në ngarkim Ministria e Shëndetësisë për këtë qëllim, t'ia kalojë Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

3. Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit për të përballuar shpenzimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi për periudhën gusht-dhjetor 1992, i shtohen 9 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Për vitet e ardhshme këto shpenzime të parashikohen në planet e buxhetit.

4. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe të Ekonomisë, të nxjerrë udhëzimin përkatës për mënyrën e organizimit të aktivitetit, si dhe të financimit dhe likuidimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi